



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 1, datë 16.2. 2016

P Ë R

**MIRATIMIN E AUTORIZIMIT, “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR”,
PËR VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE, ME OBJEKT
“NDËRTIMI I SEKSIONIT DETAR TË GAZSJELLËSIT TRANS
ADRIATIK PIPELINE (TAP)”**

Në mbështetje të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 8, të nenit 4, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” dhe të vendimit nr.416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e autorizimit “Për përdorim të burimit ujor”, për veprimtari ndërtimore në brigje, subjektit “Trans Adriatic Pipeline AG”, me objekt “Ndërtimi i seksionit detar të projektit të gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (TAP)”.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

EDI RAMA

